

VENDIM
Nr. 73, datë 3.2.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE”, BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike”, Bashkia Elbasan.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “tokë arë”, me sipërfaqe 14 500 (katërmëdhjetë mijë e pesëqind) m², me vlerë të përgjithshme prej 3 219

000 (tre milionë e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 219

000 (tre milionë e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Elbasan, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Elbasan.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Elbasan të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 14 500 (katërmëdhjetë mijë e pesëqind) m² “tokë arë” për realizimin e projektit “Zgjerimi i varrezave publike” të bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan dhe Bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË SHPRONËSIMIT, QË DO TË PËRDORET PËR “ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT”,
BASHKIA ELBASAN

Nr.	Emri mbiemri	Nr. i pasurisë	ZK	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja që shpronësohet në m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në lekë	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Ahmet Mustafa Kadzadej dhe bashkëpronarët	227/4	8527	Arë	3500	222	777000	Konfirmim nga ZVRPP-ja
2	Ardian Petrit Burimi dhe bashkëpronarët	227/5	8527	Arë	5000	222	1110000	Konfirmim nga ZVRPP-ja
3	Çlirimtar Abedin Kotherja Fatmir Abedin Kotherja	227/3	8527	Arë	6000	222	1332000	Konfirmim nga ZVRPP-ja
	TOTALI				14500		3219000	